



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

RAPORT

Nr. i Regjistrimit 412/01

MUHARREM SADIKU

kundër

Gjykatës Komunale në Gjilan

Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi krijimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe të Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit, më 29 prill 2002:

ka publikuar raportin vijues:

PROCEDURAT PARA OMBUDSPERSONIT

1. Më 29 gusht 2001, z. Muharrem Sadiku (në tekstin e më tutjeshëm aplikanti) ka paraqitur një ankesë para Ombudspersonit ku ankohej për zgjatjen e procedurës në çështjen e tij të punës. Ankesa përkohësisht ishte regjistruar më 1 shtator 2001 (Numri i regjistrimit të përkohshëm 412/01). Më 23 nëntor 1998, aplikanti ishte ankuar pranë Gjykatës së qarkut në Gjilan (më tutje Gjykata e qarkut) kundër vendimit të Gjykatës komunale në Gjilan (më tutje Gjykata komunale). Që nga ajo datë deri në datën e paraqitjes së aplikacionit pranë Ombudspersonit, aplikanti nuk ka pranuar asnjë informatë lidhur me statusin e çështjes së tij nga Gjykata komunale dhe nga Gjykata e qarkut.

2. Më 18 shtator 2001, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit e shqyrtoi çështjen në fjalë me administratorin e Gjykatës së qarkut. Administratori sqaroi se me çështjen e aplikantit do të merren në kohë të duhur dhe se arsye për vonesë ishin parregullsitë në mesin e çështjeve në Gjykatë të krijuara nga dhe gjatë konfliktit të vitit 1999. Përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit e informoi aplikantin lidhur me këtë bisedë.

3. Më 10 janar 2002, një përfaqësues i institucionit të Ombudspersonit e shqyrtoi çështjen e aplikantit me administratorin e Gjykatës komunale. Pas kësaj bisede, administratori përcaktoi se Gjykata e qarkut kishte lëshuar një vendim mbi çështjen e aplikantit më 19 janar 1999.

4. Më 15 janar 2002, Institucioni i Ombudspersonit e informoi aplikantin se vendimi mbi çështjen e tij ishte lëshuar dhe e këshilloi atë që të marrë një kopje të vendimit nga Gjykata komunale.

5. Më 19 janar 2002, Ombudspersoni hapi hetimet zyrtare lidhur me këtë çështje (Nr. i regjistrimit 412/01) dhe e informoi Gjykatën komunale për veprimin e ndërmarrë.

6. Më 30 janar 2002, Ombudspersoni pranoi një letër nga kryetari i Gjykatës komunale, ku sqarohet që vendimi i 19 janarit 1999 (shih par.11 të mëposhtëm) iu kishte komunikuar aplikantit.

LIDHUR ME FAKTET

7. Më 1993, aplikanti ishte përjashtuar nga puna e tij në komunën e Gjilanit. Ai ishte ankuar kundër këtij vendimi pranë Gjykatës komunale. Më 12 prill 1996, Gjykata vendosi në favor të tij. Komuna ishte ankuar kundër këtij vendimi pranë Gjykatës së qarkut.

8. Më 25 nëntor 1996, Gjykata e qarkut e anuloi vendimin e Gjykatës komunale të 12 prillit 1996 dhe e ktheu çështjen në të njëjtën gjykatë. Më 27 mars 1997, Gjykata komunale përsëri vendosi në favor të aplikantit. Përsëri, komuna ishte ankuar pranë Gjykatës së qarkut. Më 11 dhjetor 1997, Gjykata e qarkut përsëri e ktheu çështjen në Gjykatën komunale.

9. Më 13 tetor 1998, Gjykata komunale vendosi për të tretën herë mbi këtë çështje. Megjithatë, në këtë rast Gjykata komunale vendosi kundër aplikantit.

10. Më 23 nëntor 1998, aplikanti paraqiti ankesë kundër këtij vendimi pranë Gjykatës së qarkut.

11. Më 19 janar 1999, Gjykata e qarkut vendosi kundër aplikantit. Megjithatë, vendimi nuk iu kishte komunikuar aplikantit.

12. Në bisedën me përfaqësuesin e Institucionit të Ombudspersonit, aplikanti pohoi se ai disa herë gjatë vitit 2001 iu kishte drejtuar Gjykatës komunale dhe të qarkut me qëllim që të marrë informata rreth statusit të procedurave lidhur me çështjen e tij.

13. Më 7 gusht 2001, Gjykata e qarkut i tha aplikantit se ai duhet ta "riaktivizojë" çështjen e tij.

14. Më 8 gusht 2001, aplikanti bëri një kërkesë me shkrim pranë Gjykatës së qarkut për të riaktivizuar çështjen e tij.

15. Më 10 janar 2002, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit e shqyrtoi çështjen e aplikantit me administratorin e Gjykatës komunale. Pas kësaj bisede, administratori përcaktoi se Gjykata e qarkut kishte marrë një vendim mbi çështjen e aplikantit më 19 janar 1999. Përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit e informoi aplikantin për këtë bisedë, dhe i sugjeroi atij që të shkojë në Gjykatën komunale me qëllim që të kërkojë kopjen e vendimit.

16. Më 28 janar 2002, Gjykata komunale i dërgoi aplikantit vendimin e Gjykatës së qarkut të 19 janarit 1999.

INSTRUMENTET RELEVANTE

17. Neni 1.1 i Rregullorës së UNMIK-ut 1999/ mbi Autoritetin e Administratës së Përkohëshme në Kosovo (25 korrik 1999) në pjesë të veçant thotë:

Gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën , duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

18. Neni 337 i Ligjit mbi Procedurën Civile (Gazeta Zyrtare e RSFJ 4/77), në pjesën përkatëse thotë:

[përkthim jozyrtar]

Aktgjykimi duhet të pregatitet me shkrim mbrenda tetë ditëve nga data kur është lëshuar [...] Të gjitha palët duhet të marrin kopjet e vërtetuara të aktgjykimit, me udhëzimet për të drejtën e tyre për të kërkuar mjete kundër atij aktgjykimi.

19. Neni 248 i Ligjit të Përgjithshëm të Procedurës Administrative (Gazeta Zyrtare e RFSJ 47/86) thotë:

[përkthim jozyrtar]

Autoriteti i cili e ka bërë vendimin e shkallës së dytë, zakonisht ia dërgon vendimin bashkë me shkresat e lëndës autoritetit të shkallës së parë, i cili është i obliguar që të njejtin të ua dorëzojë palëve mbrenda tetë ditëve nga dita e pranimit të shkresave të lëndës.

20. Paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (4 nëntor 1950) (më tutje Konventa evropiane për të drejtat e njeriut ose Konventa), në pjesën përkatëse thotë:

Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile [...] secili ka të drejtë në seancë të drejtë dhe publike mbrenda një afati të arsyeshëm...

21. Neni 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut thotë:

Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe atëherë kur kjo shkelje mund të jetë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

ANALIZAT

E drejta për seancë të drejtë brenda një afati të arsyeshëm: Neni 6 i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut

22. Aplikanti ankohet se dështimi i Gjykatës komunale për të komunikuar vendimin e Gjykatës së qarkut të 19 janarit 1999, deri më 28 shkurt 2002, kishte përbërë shkelje të së drejtës së tij për seancë të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, siç është paraparë me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, i cili thotë:

Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile [...] secili ka të drejtë në seancë të drejtë dhe publike mbrenda një afati të arsyeshëm...

23. Ombudspersoni përkujton se e drejta precedente e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut ka vendosur se në çështjet civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykim është ekzekutuar. Ombudspersoni poashtu përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përshkruan ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet nga rrethanat e veçanta të çështjes. Lidhur me këtë, një nga faktorët që duhet të merret në konsiderim është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative. Ombudspersoni poashtu përkujton se, është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre brenda një kohë të arsyeshme. (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrrës*, më 13 korrik 1983).

24. Ombudspersoni vëren se, në çështjen në fjalë, është e pakontestueshme se vendimi i Gjykatës së qarkut të 19 janarit 1999 nuk i ishte komunikuar aplikantit deri pas skadimit të tri viteve. Më tutje, Ombudspersoni vëren se, edhe duke marrë parasysh ndërprerjet në sistemin gjyqësor të shkaktuara nga konflikti i vitit 1999, aplikanti ka teguar përqëndrim të duhur duke u munduar që prej përfundimit të konfliktit të sigurojë

informata lidhur me statusin e rastit të tij. Vonesat e mëdha për të ia siguruar aplikantit vendimin mbi çështjen e tij mund të konsiderohen se janë shkaktuar vetëm nga autoritetet përgjegjëse gjyqësore.

Konkludimi

25. Prandaj, Ombudspersoni konkludon që ka pasur shkelje të së drejtës për seancë të drejtë brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

E drejta për mjete efektive: Neni 13 i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut

26. Aplikanti ankohet se mungesa e cilit do mjeti efektiv për shkeljen e të drejtës së tij për seancë të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, përbën shkelje të së drejtës së tij për mjete efektive sipas nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe atëherë kur kjo shkelje mund të jetë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.

27. Lidhur me fushën e zbatueshmërisë së nenit 13, Ombudspersoni përkujton se Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administratën e drejtësisë lidhur me palët kontestuese të cilat nuk kanë mjete përbënë një kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor. (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999; dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Ombudspersoni poashtu përkujton se edhe pse Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut ka vendosur se mjetet efektive do të duhej të interpretohen në atë mënyrë që të kuptohen se mjetet mund të jenë efektive në kuptim të spektrit të kufizuar të një mjeti efektiv brenda një konteksti të veçantë. (Aktgjykimi në rastin *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, më 6 shtator 1978), ajo poashtu ka vendosur edhe si vijon:

Për sa i përket dështimit të pohuar për të siguruar seancë brenda një afati të arsyeshëm [...] asnjë kualifikim i përmbajtur në fushën e nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me Konventë do të përkrahte mbajtjen në minimum të kufizimeve të nënkuptuara me nenin 13 (Aktgjykimi në rastin *Kudla kundër Polonisë*, më 26 tetor 2000).

Prandaj, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm në çështjen në fjalë.

28. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Ombudspersoni përkujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë që një dispozitë e një mjeti vendor të merret me substancën e "një ankese të kontestueshme" sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih, p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih, p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Lidhur me ankesën për zgjatje të procedurës, Ombudspersoni përkujton se "mjetet efektive" në kuptim të nenit 13 do të

duhej që ose të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar ose vazhdimin e saj, ose për të ofruar përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmëtur *Kudla*).

29. Ombudspersoni vëren se asnjë mënyrë specifike ligjore nuk ka ekzistuar në çështjen në fjalë, përmes së cilës aplikanti do të kishte mundur të ankohej për zgjatje të procedurës me çfarëdo parashikimi apo shprehje për ta arritur çfartëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

Konkludimi

30. Prandaj, Ombudspersoni konkludon që ka pasur shkelje të së drejtës për mjete efektive të garantuar me nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

REKOMANDIMET

31. Ombudspersoni rekomandon që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, do të duhej që, jo më vonë se më 31 maj 2002:

- të lëshojë një udhëzim zyrtar të gjitha gjykatave që funksionojnë në Kosovë: 1) që të shqyrtojnë shkresat e lëndës të të gjithë rasteve për të cilat vendimi dhe/ose aktgjykimi është lëshuar gjatë vitit 1998 dhe 1999; 2) që të dokumentojnë komunikimin e këtyre vendimeve dhe aktgjykimeve palëve përkatëse, dhe 3) që të kryejnë këto obligime brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të kërkesave të nenit 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut,
- të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv, në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut;
- të informojë Ombudspersonin për veprimet e ndërmarra si përgjegjje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura, në pajtim me nenin 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.

Marek Antoni Nowicki
Ombudspersoni